

AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “SARAYLI” SH.P.K.

Neni 1

Formimi

Sot me datë 11.08.2022 mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në përputhje me Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”, Kodin Civil dhe Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “SARAYLI” SH.P.K.

Kjo shoqëri krijohet nga:

1. **Uğur Tıraş**, i datëlindjes 10.11.1974, lindur në Turqi dhe banues në Tiranë,

Neni 2

Selia

Selia e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “SARAYLI” SH.P.K. është në adresën: Rruga Astrit Losha, Pallat, Zona Kadastrale 3866, Pasuria Nr.299/199-N6, Kati I-re, Dyqani Nr.6, Unaza e Re, Kashar-Tiranë.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “SARAYLI” SH.P.K. është e pacaktuar.

Neni 4

Objekti Veprimtarisë

1. Të hapë dhe menaxhojë pastiçeri dhe furrë buke.
2. Të tregtojë produkte të brumit dhe ëmbëlsira me shumicë dhe pakicë.
3. Të prodhojë ëmbëlsira të ndryshme.
4. Të prodhojë produkte brumi
5. Të prodhojë dhe tregtojë akullore
6. Import i mallrave ushqimore e industriale dhe makinerive të prodhimit për nevojat e veta.
7. Të importojë, eksportojë dhe tregtojë mallra ushqimore e industriale dhe makineri të prodhimit
8. Të importojë, eksportojë dhe tregtojë çdo lloj material dhe produkti, që lidhet me aktivitetin.
9. Të paketojë dhe tregtojë me shumicë dhe pakica të gjitha produktet e prodhuara nga ana e saj.



10. Të marrë pjesë në tendera dhe ankande etj.
11. Të hapë dhe menaxhojë Pastiçeri, Bar, Restorant, Hotel, Motel etj.
12. Të hapë dhe menxhoje sallone bukurie, parukeri, etj.
13. Të hapë dhe menaxhojë qendra masazhi.
14. Të hapë dhe të menxhojë salla sporti, Fitnes dhe të ngjashme
15. Të importojë, eksportojë dhe tregojë tekstile, veshje të ndryshme dhe të ngjashme me shumicë dhe pakicë
16. Të importojë dhe eksportojë dhe të tregtojë ene kuzhine me shumicë dhe pakicë.
17. Të tregtojë me shumicë dhe pakicë si dhe të importojë dhe eksportojë materiale ndërtimi.
18. Të hapë qendra kursesh për masazhe dhe sallone bukurie dhe parukerie
19. Transporti per nevojat vetjake dhe per te tretet te behet me te gjitha mjetet e shoqerise apo me mjete te tjera qe shoqeria ka ne perdorim ose do të marrë me qira
20. Grumbullimi, magazinimi dhe transporti i produkteve te para dhe te ndërmjetme për prodhim si dhe produkteve të gatshme për rishitje
21. Marketingu i lokaleve tregtare nepermjet shitjes, qirase, dhenies ne perdorim apo çdo lloj marredhenie tjeter kontraktore te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.
22. Të shërbejë si distributor i shoqërive dhe markave të ndryshme vendi dhe të huaja. Të përfaqësojë shoqëri të huaja.
23. Të importojë dhe eksportojë të gjitha materialet dhe shërbimet e lejuara nga legjislacioni shqiptar.
24. Të importojë të gjitha materialet dhe shërbimet e lejuara nga legjislacioni shqiptar për nevojat e veta dhe t'i përdorë ato.
25. Të kryejë shitblerjen me shumicë dhe pakicë të të gjitha materialeve dhe shërbimeve të lejuara nga legjislacioni shqiptar.

Neni 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë "SARAYLI" SH.P.K. është 1.000 (një mijë) Lekë, i ndarë në 1 kuotë si vijon:

1. **Uğur Tıraş** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1.000 (një mijë) Lekë që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6

Organet e Shoqërisë dhe Asambleja

Organet drejtuese të shoqërisë "SARAYLI" SH.P.K. janë:

- Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendim – marrës.
- Administrator i shoqërisë, është **Z.Uğur Tıraş**. Shoqëria do të administrohet nga **Z.Uğur Tıraş**, si administrator i saj, i cili përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.



Neni 7

Të drejtat e detyrat e asamblesë, organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizikë e juridikë vendas apo të huaj, shprehen në statut, i cili bashkë me aktin e themelimit janë dokumentat bazë të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e aktiviteteve të saj.

Neni 8

Veprimtarinë e saj, shoqëria do t'a zhvillojë në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

Neni 9

Të gjitha mosmarrëveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore zgjidhen me mirëkuptim, me anë të dispozitave të këtij akti, statutit dhe legjislacionit shqiptar dhe kur këto mjete nuk japin rezultat atëherë zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Akt Themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "SARAYLI" SH.P.K. në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Tiranë. Në këtë ditë shoqëria "SARAYLI" SH.P.K. njihet si person juridik.

Neni 10

1. Ky akt formulohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet në 1(një) kopje.
2. Ortaku i shoqërisë i jep të drejtën **Z.Ugur Tiraş**, të paraqitet pranë QKB-së dhe çdo institucioni tjetër për regjistrimin e shoqërisë "SARAYLI" SH.P.K.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

Uğur Tiraş



Uğur TIRAŞ